



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 401-23808/2026

Datë: 03.08/2026

Duke u mbështetur në nenin 12, nenin 17 dhe nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 44 dhe 48 të Ligjit Nr. 08/L-277 për Sportin, nenin 10 të Rregullores Komunale për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e rregullt të mbajtur më datë 31.07.2026, miratoi këtë:

V E N D I M

Për ndarjen e mjeteve financiare për KF "Dukagjini"

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej **40,000.00 €** (katërdhjetë mijë euro) për Klubin Futbollistik "Dukagjini", si shpërblim për suksesin e arritur sportiv me rastin e fitimit të Kupës së Kosovës në futboll.
2. Mjetet e përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi ndahen me qëllim të mbështetjes së klubit për zhvillimin e veprimtarisë sportive, përmirësimin e kushteve të funksionimit dhe stimulimin e rezultateve sportive.
3. Mjetet financiare në shumën prej 40,000.00 € ndahen nga Programi Zyra e Kryetarit (160), nënprogrami 16018, kodi funksional 0111, në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, dhe njësitë tjera përgjegjëse.
5. Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunës;
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
- KF "Dukagjini";
- Zyra për Informim;
- Arkiv

